



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.2023

UDHËZIM

Nr. 78, datë 16.02.2023

PËR

LLOGARITJEN E PAGËS REFERUESE BAZË TË MAGJISTRATIT (GJYQTAR)

Këshilli i Lartë Gjyqësor, në mbështetje të ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", i ndryshuar, ligjit nr. 84/2022 "Për Buxhetin e vitit 2023", nenit 12 pika 5 shkronja “a” ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtareve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, sipas gjendjes së dispozitës para ndryshimeve me ligjin nr. 50/2021, Vendimit nr. 35, datë 22.11.2022, të Gjykatës Kushtetuese, me propozim të Komisionit të Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit,

UDHËZON:

1. Llogaritjen e “pagës referuese bazë” të magjistratit (gjyqtar), nga data 09 janar 2023 e në vazhdim, sipas VKM nr. 621/2022, e barabartë me vlerën e “pagës për funksion” të punonjësit të shërbimit civil Klasa e parë (I), Kategoria e dytë (I-b), niveli I-b.
2. «Paga referuese bazë» e magjistratit (gjyqtar), të llogaritet si shumatore e vlerës së «shtesës për pozicion» e përcaktuar në VKM nr. 621/2022, në shumën 138,700 lekë me vlerën e «pagës së grupit» në shumën 14,000 lekë, në total në shumën 152,700 lekë (138,700 + 14,000).
3. Përlllogaritjen e fondeve buxhetore shtesë për vitin 2023, për sistemin gjyqësor, për periudhën 09 janar 2023 deri 31 dhjetor 2023, duke mbajtur parasysh si “pagë referuese bazë” për funksionet gjyqësore, atë të përcaktuar në pikën 1 dhe 2 të këtij udhëzimi.
4. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm dhe Departamenti i Programimit dhe Administrimit të Buxhetit në Këshillin e Lartë Gjyqësor për zbatimin e këtij udhëzimi detyrues.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR